



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 21/7 DATË 18 / 07 / 2022**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT  
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR  
PROJEKTIN E INVESTIMIT “FAFA RESORT” ME SUBJEKT APLIKUES “FAFA  
RESORT” SHPK NUIS M01321002G**

Në mbështetje të Nenit 8, 9, 13 dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti “Fafa Resort” konsiston në ndërtimin e një resorti turistik, me një hotel me njëmbëdhjetë kate, katër godina apartamentesh dhe pesë vila individuale me një kapacitet total prej 519 dhomash në ZK 2099, në Fshatin Golem, Bashkia Kavajë;
- Projekti synon të realizohet nga subjekti “Fafa Resort” shpk, me NUIS M01321002G;
- Vlera e investimit për këtë projekt parashikohet të jetë 63,126,676 (gjashtë e tre milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtë qind e shtatëdhjetë e gjashtë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 550 (pesëqind e pesëdhjetë) persona.

- Projekti synon të realizohet në një sipërfaqe prej 6.8 ha. Pasuritë nr. 2/2 dhe nr. 2/1 në ZK nr. 2099, Bashkia Kavajë, janë në pronësi të subjektit aplikues. Subjekti kërkon masë mbështetëse përdorim të pasurive të paluajtshme, përkatësisht pasuritë nr. 2/3, e llojit kadastral “ranishte” dhe parcelën nr. 1/17 e llojit kadastral “arë”, parcela për të cilat nuk përputhet situata faktike me situatën juridike;
- Referuar Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 2, datë 27.04.2018, zona ku do të zhvillohet projekti bën pjesë në njësinë G3-B1-01, zhvillimi i të cilës sipas rregullores së këtij plani, kushtëzohet me hartimin e Planit të Detajuar në Zonën e Rëndësisë Kombëtare (PDZRK). Projekti nuk përputhet me PPV e Bashkisë Kavajë, pasi PPV aktuale ka të parashikuar zhvillime “Aktiviteteve ekonomike dhe bujqësore, aktivitete sociale dhe rekreative si dhe zona ujore”.
- Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për shqyrtim në Komitetin e Investimeve Strategjike për përfshirjen e projektit investues “Fafa Resort”, me subjekt investues “Fafa Resort” sh.p.k. NUIS M01321002G, Fshati Golem, Bashkia Kavajë në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti nuk mund të trajtohet për përfitim të statusit strategjik pa iu nënshtruar zona përmirësimit/regjistrimit të bllokut kadastral.
3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për përfitim /përmirësim/regjistrim të bllokut kadastral.

4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

EDI RAMA

**ZËVËNDËSKRYEMINISTËR**

ARBEN AHMETAJ

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

DELINA IBRAHIMAJ

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

FRIDA KRIFCA

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO